

Republika e Maqedonisë, ngjajshëm sikurse edhe vendet tjera të Evropës Juglindore, është e konfrontuar me disa probleme që janë krijuar si pasojë e ndryshimit të sistemit dhe shkatrrimit të Jugosllavisë, ose, madje, ka të bëjë me zhvillimin e parregullt gjatë sistemit njëpartiak jugosllav. Pas pavorsimit të vet, Maqedonia gjendet në proces të vazhdueshëm institucional, shoqëror dhe ekonomik të tranzicionit kah një shteti i orientuar demokratik dhe me ekonomi të tregut.

Pasojat e konflikteve luftarake dhe fragmentimit të ish Jugosllavisë lën gjurmë edhe në Maqedoni. Edhe pse në rrugën kah pavorsia e vet, për dallim nga republikat tjera jugosllave, në Maqedoni nuk kishte gjakëderdhje, prapse prap shteti nuk u kursye nga pasojat tjera negative. Infrastruktura e shpërndarë në mënyrë të pabarabart dhe rrugët tregëtare në Jugosllavi u ndërpre në qysh në fillimin e viteve të '90-ta, kurse embargo të shumta dhe refugjatët në mënyrë të plotësuar e vështirsuan procesin zhvillimor të rajonit.

Gjatë luftës në Kosovë, Maqedonia pranoi numër të madhë të refugjatëve nga Kosova dhe kontribuoi për zbutjen e katastrofës humanitare. Në vitin 2001, papritmas u krijua një konflikt i brendshëm midis grupeve shqiptare dhe forcave maqedonase të sigurisë. Me ndihmën e ndërmjetësimit ndërkombëtar, konflikti përfundoi me Marrëveshjen kornizë të Ohrit, me të cilën minoritetit shqiptar në këtë shtet i mundësohen të drejta më të gjëra dhe qëllimi i të cilës është barazia faktike, e jo vetëm deklarative e Shqiptarëve. Përveç kësaj, me këtë marrëveshje parashihet edhe decentralizimi i shtetit, me të cilin duhet të zvogëlohet distanca midis qytetarëve dhe strukturave shtetërore.

Implementimi i marrëveshjes paqësore, anëtarësimi i ardhshëm në NATO dhe përafrimi i Maqedonisë kah Bashkimi Evropian, janë projektet qendrore reformike të shtetit. Implementimi i Marrëveshjes së Ohrit duhet të përfundojë qysh në vitin 2006, kurse Maqedonia e pret anëtarësimin në NATO në vitin 2006 dhe njohjen e statusit të vendit-kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, poashtu, në vitin 2005.

Qëllime dhe detyra

Fondacioni Fridrih Ebert në Maqedoni e mbështet procesin e transformimit të shtetit në këto sfera, si vijon:

- Civil society engagement and activism
- Social Dialog
- Macedonia's EU Integration process

- Regional cooperation in the Western Balkan

Në punën e vet, Fondacioni Fridrih Ebert udhëhiqet sipas vlerave themelore të demokracisë sociale: liri, drejtësi, solidaritet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Këtë detyrë Fondacioni Fridrih Ebert e ndjek edhe në Republikën e Maqedonisë, ku e ka zyrën e vet nga viti 1996.